



LOERMA SHPK

Laborator i Akredituar
Gjithmone prane jushi!

I. HYRJE.

Subjekti ENEA GREKU është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti M02619001A.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: Berat, Moravë, rruga nacionale Berat-Dimal, zona kadastrale 2723.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: “Mirëmbajtje dhe riparime të automjeteve, tregtim mallra të përdorura”.

Administratori i këtij subjekti është Z. Enea Greku.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me **ID 10.4, industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve: Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligjin Nr 10431, datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" (I ndryshuar).
- Ligjin Nr 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (I ndryshuar).
- Ligjin Nr. 10448 dt.14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” (I ndryshuar).
- Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” (I ndryshuar).

- Ligjin Nr.10 266, datë 15.04.2010 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligjin Nr. 9774 datë 12.07.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".
- Ligjin Nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura";
- Ligjin Nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme".
- Ligjin 10.237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin nëpunë".
- Ligjin Nr .9199, date 26.2.2004 Për Prodhimin, Përpunimin, Çertifikimin dhe Tregtimin e Produkteve "Bio".
- Ligjin Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Ligjin Nr. 87/2013 "Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit",
- VKM, Nr. 555, datë 27.06.2013, për miratimin e rregullores "Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit"
- Draft-rregullore "Për ngritjen dhe funksionimin e Panel Testit për vlerësimin organoleptik të vajit të ullirit".
- V.K.M. Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".
- V.K.M. Nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transfekimin e mbetjeve jo të rrezikëshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit."
- V.K.M. Nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- V.K.M. Nr. 841, datë 03.12.2014 Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me dridhjen mekanike në vendin e punës".
- V.K.M. Nr. 842, datë 3.12.2014 Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës"
- V.K.M. Nr. 313, datë 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis".
- V.K.M. Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave".
- V.K.M. Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- V.K.M.Nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
- V.K.M Nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve".

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

Veprimtaria e mirëmbajtjes dhe riparimeve të automjeteve zhvillohet në një zonë rurale, në Berat, Moravë, rruga nacionale Berat-Dimal që administrohet nga Bashkia Berat. Trualli ku zhvillohet kjo veprimtari gjendet në krahun verior të rrugës nacionale Berat-Dimal.

Subjektit Fizik, "ENEA GREKU", për një periudhë kohe 4 vjeçare, ushtron aktivitetin në veprimtarinë në kryerjen e shërbimeve elektro-mekanik të automobilëve.

Kjo veprimtari zhvillohet në një godinë një katëshe mbi tokë, pronë e subjektit, në të cilën janë instaluar të gjitha makineritë dhe pajisjet bashkëkohore të një servisi makinash.

Hapësirat e brendëshme si dhe ato të jashtme, brenda territorit në pronësi të subjektit janë organizuar në përshtatje me aktivitetet që zhvillon aktualisht si dhe me atë që përgatitet të zhvillojë ky subjekt.

Po kështu janë ndërtuar dhe plotësuar mirë vendet e punës për, shërbimin që ofron/kryen ky subjekt, ambjentet e zyrave, ato hidrosanitare etj. në përshtatje me numurin e fuqisë punëtore, kohën e punës, ditët e punës në muaj dhe në vit në përputhje me kapacitetet prodhuese mujore e vjetore.

Kjo veprimtari zhvillohet në përbërje të disa sektorëve organikë:

- Zyra teknike e administrative.
- Sektori i kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike të automjeteve të tipeve dhe madhësive të ndryshme.
- Magazinimi i pjesë të cilat mund të ripërdoren.
- Magazinimi të mbetjeve të rrezikëshme dhe të atyre jo të rrezikëshme.

Ambjentet e punës, sipërfaqet e pazëna me ndërtime si dhe godina ku zhvillohen operacionet e punës, plotësojnë kërkesat e pikës Nr 1 të Nenit 7 të Udhëzimit Nr 1546, datë 29.3.2016 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove".

3.1 Kryerja e shërbimeve elektro-mekanike.

Në tërësi aktiviteti zhvillohet në ambjente të përshtatëshme për operacionet e punës që zhvillohen në to si dhe duke mos krijuar dëme apo efekte negative të ndryshme në mjedisin ku zhvillohen dhe rreth tij.

Kemi të bëjmë me një objekt tërësisht të hapur nga ana jugore e tij, me një shesh dhe dysheme të shtruar me beton dhe pllaka majolike, duke siguruar një lëvizje normale të automjeteve që do t'i nënshtrohen kontrollit teknik si dhe kryerjes së riparimeve të ndryshme elektro-mekanike.

Kontrolli i përgjithshëm teknik i mjetit, kryhet sapo futesh në teritorin e subjektit, në prani të pronarit apo drejtuesit të mjetit. Përcaktohet lloji i difektit, mundësitë e riparimit të tij, pjesët e ndërrimit të nevojshme, sasia e parave që duhen paguar, dhe nëse për të gjitha këto, ka një pranim të dyanshëm, mjeti i nënshtrohet procesit të riparimit.

Sapo futesh në këtë objekt, në anën e majtë tij, gjendet një godinë e organizuar në formën e një magazine, ku në raftet metalike janë sistemuar pjesë këmbimi të përdorura dhe pjesë këmbimi të reja. Në marrëveshje me klientin këto pjesë mund të ripërdoren në mjetin që riparohet.

Automjeti që do t'i nënshtrohet shërbimit dërgohet në ambjentet e përshtatura për kryerjen e tyre. Subjekti ka ndërtuar dy gropa për kryerjen e kontrolleve dhe shërbimeve xhenerike. Ato kanë pëmasat 8.0 x 1.1 m. Këto gropa shërbimesh xhenerike, gjenden në krahun e majtë të hyrjes në ambjentet e punës së këtij subjekti. Në krahun e djathtë gjenden dy vinxha me kollona metalike që shërbejnë për ngritjen e mjetit nga toka deri në 2,5 m. Kështu, në këtë sektor të kontrollit teknik dhe të kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike, mund të trajtohen njëkohësisht 2 automjete.

Në këtë sektor servisi, kryhet kontrolli teknik dhe riparimi apo sjellja në normalitet i automjeteve të përdorimit familjar dhe mjete transporti të tonazhit të vogël deri në 5 ton. Kontrollat dhe riparimet që kryhen janë kryesisht ato motorrike dhe ato xhenerike.

Punimet xhenerike janë të përqëndruara në kontrollin dhe riparimin e pjesëve apo nyjeve të sistemeve të:

- drejtimit të automjetit, ndërrim të kokave të zbarës, paralelit etj.
- frenimit si, ndërrim të çepave të frenave, tubove apo të pompës së alkolit, rregjistrim të frenave etj.
- transmetimit të fuqisë motorrike dhe të kutisë së shpejtësisë. Ndërrim të vajit të tyre, grasatime apo dhe zëvendësim të pjesëve të konsumuara.

Këtu mund të bëhet edhe ndërrim i vajit të motorrit, filtrave të naftës/benzinës, të ajrit të sistemit të kondicionimit të ajrit etj.

Në ambjentet e këtij servisi janë të instaluar pajisje të kohës që shërbejnë për vlerësimin e gjendes teknike të mjetit në përgjithësi si dhe të sistemeve të veçanta. Ndër pajisjet specifike mund të listojmë në vijim:

- Dy vinxha me kollona metalike që shërbejnë për ngritjen e mjetit nga toka deri në 2,5 m.
- Një vinxh urë me hapsirë drite rreth 14 m, dhe peshë ngritje deri 5 ton.
- Një prese hidraulike deri 120 atm, për vendosjen apo nxjerrjen e gushinëtave.
- Një trapan bangoje.
- Një barreno, për kryerjen e punimeve të blloku të motorrit.
- Një limatriçe.
- Një torno horizontale.
- Morseta bangoje të madhësive të ndryshme.
- Motokompresori për ajër të ngjeshur, me anë të të cilit punojnë pajisje për shtërngimin/lirimin e bollonave, dadiçekëve etj.
- Karrocet - krik me ajër, për ngritjen e pjesëshme të mjetit.
- Fuçi metalike e plastike me vëllim 50 – 100 litra në të cilat mbahen vajrat e grasot e përdorura të cilat dërgohen për riciklim të subjekte që merren me këtë përpunim të mëtejshëm të tyre.

Krahas tyre ka edhe pajisje ngritëse e transportuese, pajisje shtërnguese, trapanë e gurëzmerili dore, sete të ndryshëm çelësash, kaçavidash, darësh e pincash etj. Në një ambjent të përshtatshëm gjendet një bombël oksigjeni, së bashku me një bombol gazi, si dhe pajisjet e tjera teknike të nevojshme për të bërë ngjitje/prerje duke përdorur flakën e oksigjenit.

Është një punë e kufizuar në shërbim të dy apo më shumë mjeteve për shkak të hapësirave punuese në dispozicion, si kryerjes së punës individuale dhe të drejtpërdrejtë të punonjësit përkatës.

Me përfundimin e zëvendësimit të pjesëve apo nyjeve të konsumuara, mjeteve ndizet dhe i nënshtrohet një prove me ngarkesë, në hapësirat e brendshme të këtij objekti. Nëse çdo gjë rezulton në rregull, atëherë mjeteve i jepet pronarit të vet. Prova bëhet me praninë ose jo të pronarit të mjetit.

Është e rëndësishme të theksojmë që, në këtë aktivitet nuk bëhen larje e automjeteve, si dhe lyerje me bojë e pjesëshme apo e plotë e automjeteve.

Brenda teritorit të objektit, në pjesën hyrëse të tij, është ndërtuar një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që presin të riparohen dhe/ose presin të marrin pronarët e tyre. E gjithë kjo veprimtari ka kapacitete relativisht të vogla, për shkak të kryerjes së punës individuale. Nuk kemi punë të programuara në seri duke trajtuar të njëjtat tipe mjeteve motorrike me të njëjtat defekte. Pothuajse çdo gjë është e rastit, duke krijuar shpesh mbingakesa ose ditë të tëra pushimi pa punë.

Çdo proces teknologjik i kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike shoqërohet me vlerësime teknike sipas dy kategorive bazë:

- a) Lëndë apo pjesë të cilat ***mund të ripërdoren*** në destinacionin për të cilat ato janë prodhuar. Të gjitha këto lëndë apo pjesë pastrohen, dhe inventarizohen në rregjistrat përkatës dhe vendosen në sektorin/magazinën e reklamimit dhe të tregtimit të tyre.
- b) Lëndë apo pjesë të cilat ***nuk mund të ripërdoren*** në destinacionin për të cilat ato janë prodhuar duke u vlerësuar kështu si mbetje. Të gjitha këto lëndë apo pajisje i nënshtrohen procesit të seleksionimit në bazë të llojit të tyre si psh: vajra lubrifikantë, lëndë djegëse, metale të hekurit, aluminit, bakrit, pjesë prej gome, plastike tekstile etj. Pas seleksionimit ato peshohen dhe ambalazhohen në fuçi plastike apo metalike, kuti kartoni dhe magazinohen duke u inventarizuar në rregjistrat përkatës.



IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

4.1. Lëndët e para.

Në kontekstin lëndë e para, ndihmëse dhe produkt, në rastin tonë konkret mund të japim këto përshkrime.

a. Lëndë e para, për kryerjen e shërbimeve elektro-mekanike.

Me termin lëndë të para dhe ndihmëse, në këtë veprimtari do të kuptonin dhe do të përfshinin të gjitha llojet e pjesëve të këmbimi të cilat përdoren gjatë shërbimeve elektro-mekanike të automjeteve të përdorimit familjar. Po këtu do të përfshihen edhe llojet e vajrave lubrifikanë, grasove, alkolit të frenave si dhe gazi freon për sistemet e kondicionimit të ajrit.

Pjesë këmbimi të reja, dhe/ose të përdorura. Pjesët e këmbimit të përdorura, janë hequr nga automjete të dala jashtë përdorimit kryesisht për shkak të aksidenteve rrugore. Këto pjesë janë vlerësuar nga stafi Teknik për mundësinë e ripërdorimit të tyre në destinacionin fillestar të prodhimit të tyre. Në këtë rast kemi të bëjmë me procesin e riciklimit, një detyrim ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

Vajra lubrifikantë e graso që përdoren gjatë kryerjes së shërbimeve teknike të motorrit, kutisë së shpejtësisë, pjesëve të sistemit të transmetimit të fuqisë si diferenciali, semiakset, gushimet e rrotave etj.

Filtra ajri, naftë/benzine, vaji, gazi që shërben për kondicionimin e ajrit të gabinës.

Alkol frenash.

4.2. Energjitë që përdoren.

Objekti ku ndodhet fabrika e vajit është i lidhur me rrjetin inxhinjrik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjrik janë, ai i:

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm;
- ✓ Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.

a. Furnizimi me energji elektrike.

Për zhvillimin normal të kësaj veprimtarie përdoren energjitë e përshkruara në vijim.

- Energjia elektrike.

Energjia elektrike dy dhe tre fazore merret nga rrjeti përkatës i zonës, në bazë të kontratës me Drejtorinë Rajonale të Shërndarjes së Energjisë Elektrike Berat. Energjia elektrike dy ose/apo tre fazore, shpërndahet në të gjithë pikat konsumatore të këtij subjekti, nëpërmjet rrjeteve shpërndarës të plotësuar me të gjitha pajisjet e nevojshme të lëshimit/ndalimit të pajisjeve, mbrotjes nga mbingarkesat e rrymës dhe të tensionit, tokëzimit etj.

Energjia elektrike dy fazore përdoret kryesisht për:

- Ndiriçimin e ambjenteve të punës dhe jashtë tyre të shesheve dhe rrugëve të brendëshme.
- Furnizimin e pajisjeve të ndryshme të zyrave, magazinave etj.

Energjia elektrike tre fazore përdoret për furnizimin e mjeteve të ndryshme të instaluar, si vinxhi urë, vinxhat për ngritjen e automjeteve, presa hidraulike, makinat metal prerëse të instaluar, trapan e gurëzmiri, etj.

Fuqia elektrike e instaluar në këtë subjekt është rreth 75 kWh.

b. Furnizimi me ujë.

Uji merret nga rrjeti përkatës i furnizimit të zonës së banuar.. Uji i furnizuar shpërndahet në pikat konsumatore të tij me anë të rrjetit shpërndarës. Ai përdoret për dy qëllime kryesore:

- Plotësimin e nevoja humane të punonjësve.
- Pastrimin e ambjenteve të punës dhe të pajisjeve që i nëshetrohen procesit shërbimeve elektro-mekanike.

Për të garantuar furnizimin e pandërprerë me ujë, është instaluar:

- Depozitë e ujit me vëllim 1 m³.
- Pompë e qarkullimit së bashku me tubacionet përkatëse.

Konsumi mesatar mujor i ujit rezulton në rreth 6 m³.

c. Sistem i mbrojtjes nga zjarri.

Investitori e ka vlerësuar rrezikun e rënies së zjarrit, dhe ka vendosur në pika të ndryshme të ambjenteve të tij të punës, fikse zjarri me shkumë dhe pluhur. Është e këshillueshme që, këto fikse duhet të kontrollohen nga specialistët përkatës të MNZ, për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të grumbullimit dhe tregtimit të skrapit, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

5.1. Shkarkime në ajër.

Veprimtaria e kryerjes së shërbimeve elektro-mekanike nuk përfshin zhvillimin e procese teknologjike të bashkëveprimit dhe transformimit përbërës (fiziko-kimik) gjatë zhvillimit të të cilëve të shkarkojnë gaze.

Gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije identifikohet shkarkimi i gazeve në mënyrë sporadike dhe në pika të shpërndara, atje ku zhvillohen proceset e prerjes me flakën e oksigjenit apo të harkut elektrik, të pjesëve metalike. Gjatë kryerjes së këtyre proceseve, në vendin e punës, çlirohen gaze të tilla si gazi karbonik (CO₂), gaz sulfuror (SO₂), okside të azotit (NO_x) etj. Këto lloj shkarkimesh janë të kufizuara në kohë dhe në sasi.

5.2. Shkarkime në tokë.

a. Mbetje të ngurta.

Në këtë lloj mbetjesh përfshihen:

- Filtrat e vajit, të lëndës djegëse, të gazit të kondicionuar etj.
- Pjesë metalike, plastike, gome, tekstili etj.
- Mbetjet urbane të cilat përbëhen kryesisht nga ambalazhet e letrës/kartonit, plastikës, qelqit etj.

b. Mbetje të lëngëta.

Në këto lloj mbetjesh përfshihen :

- Vajra lubrifikantë.
- Lëndë djegëse, naftë ose benzinë.
- Alkol frenash.
- Ujra që dalin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës të cilët përzejehen edhe me ujrat e shirave.
- Ujrat e zeza.

5.3. Shkarkime të ujrave të ndotur.

Uji nuk vlerësohet si pjesmarrës i drejtpërdrejtë në proceset teknike që kryhen për riparimin e automjeteve.

Ujrat ndoten edhe gjatë larjes së ambjenteve të punës si dhe nga përdorimi human në ambientet hidro-sanitare.

5.4. Shkarkime të zhurmave.

Zhurmat dhe vibrimet janë të pranishme kryesisht gjatë zhvillimit të proceseve të përshkruar në vijim :

- Procesit të prerjeve me gurë zmerili.
- Punës së mjeteve ngritëse dhe transportuese.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti ENEA GREKU me NIPT M02619001A, ushtron veprimtarinë e mirëmbajtjes dhe riparime të automjeteve në Berat, Moravë, rruga nacionale Berat-Dimal, zona kadastrale 2723.

Rajoni ku zhvillohet kjo veprimtari është kryesisht me zhvillim bujqësor, me toka arë të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore, që rriten dhe zhvillohen tradicionalisht në të. Në këtë rajon nuk ka parcela apo zona me zhvillim të veçantë bujqësor si sera diellore, etj. Duhet theksuar gjithashtu që nuk gjenden komplekse të rritjes së kafshëve të veçanta, por kudo në këtë rajon rriten kafshë dhe shpendë tradicionalë e kryesisht lopa, delja, pula, rosa, pata, etj. Sipas klasifikimit klimaterik të vendit tone, zona ku zhvillohet kjo veprimtari gjendet në zonën klimatike mesdhetare fushore të vendit tonë e cila karakterizohet nga dimra të butë e të lagësht dhe verëra të nxehta e të thata. Sasia e rreshjeve luhatet tek ato mesatare, me rreth 1100 mm shi në vit të cilat janë të shpërndara në mënyrë të çrregullt. Rrallë në këtë zonë bien rreshje dëbore, trashësi e të cilës shkon disa milimetra, por që nuk qëndron gjatë. Rreth 70 % e rreshjeve i takojnë muajve Tetor- Maj. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është rreth 15 °C. Muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare 3 °C ndërsa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare 22-25 °C.

Objekti i ndërtimit është tipologji me katin përdhes në tokë të hapur që do të shfrytëzohet për grumbullimin e skrapit. Ky objekt kufizohet nga koordinatat e sistemit gausskruger, të marra nga geoportal.asig.gov.al.

	X	Y
1	4408351.579	4514615.468
2	4408359.309	4514605.719
3	4408348.296	4514597.723
4	4408338.302	4514605.398

- **Përshkrim i faktorëve klimatikë**

Sipas klasifikimit klimaterik të vendit tonë, zona ku zhvillohet kjo veprimtari gjendet në zonën klimatike mesdhetare fushore të vendit tonë e cila karakterizohet nga dimra të butë e të lagësht dhe verëra të nxehta e të thata. Sasia e rreshjeve luhetet tek ato mesatare, me rreth 1100 mm shi në vit të cilat janë të shpërndara në mënyrë të çrregullt. Rrallë në këtë zonë bien rreshje dëbore, trashësi e të cilës shkon disa milimetra, por që nuk qëndron gjatë. Rreth 70 % e rreshjeve i takojnë muajve Tetor- Maj. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është rreth 15⁰C. Muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare 3⁰C ndërsa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare 22-25⁰C.



- **Përshkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmitetit i zonës së projektit;**

Nuk ka studim gjeomorfologjik dhe sizmitetit për zonën e projektit

- **Përshkrim i gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit;**

Rajoni ku zhvillohet kjo veprimtari është kryesisht me zhvillim bujqësor, me toka arë të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore, që rriten dhe zhvillohen tradicionalisht në të. Në këtë rajon nuk ka parcela apo zona me zhvillim të veçantë bujqësor si sera diellore, etj. Duhet theksuar gjithashtu që nuk gjenden komplekse të rritjes së kafshëve të veçanta, por kudo në këtë rajon rriten kafshë dhe shpendë tradicionalë e kryesisht lopa, delja, pula, rosa, pata, etj.

- **Përshkrim i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në zonën e projektit.**

Lumi Seman është njëri nga lumenjtë e monitoruar nga AKM. Lumi Osum është monitoruar në pikën Ura e Kuçit jo në Urën Vajgurore (në vitin 2012 është monitoruar në urën Vajgurore) Treguesit janë si më poshtë për dy fazat e monitorimit:

- Temperatura 26.4-28.3⁰C dhe 17.34-18.8⁰C
- Ph 7.63-8.38
- Alkiniteti 203-387 mol/l
- Përcjellshmëria elektrike 509-888-1744 µS/cm
- Përmbajtja e oksigjenit të tretur janë vlera të cilësisë së varfër
- Vlerat e përmbajtjes së BOD₅ 0.6-3.9 cilësi e moderuar
- Vlerat e përmbajtjes së nevojës kimike për oksigjen COD 0.56-1-3.96
- Përmbajtja e forsit total 0.03-0.05±1.63 mg/l
- Amoniaku 0-0.19-2.18 mg/l këto ujra sipas përmbajtjes së amoniakut janë cilësi e varfër

- Vlerat e përmbajtjes së nitrateve 3.2-4.4-7.2 mg/l, nivel i varfër
- Vlerat e përmbajtjes së nitriteve 0-0.05-0.56 mg/l gjëndje e mirë deri e moderuar
- Lëndët pezull janë të larta 2.8-222.2 mg/l

4.2. Përshkrim i biodiversitetit në zonën e projektit

- *Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit si dhe harta ilustruese*

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore është karakterizuar nga rritja e shkallës së sundimit dhe ndikimit të natyrës nga njeriu, pasojat kryesore të së cilës ndihen edhe sot dhe mund të klasifikohen si: a) Humbja dhe fragmentizimi i habitateve natyrore; b) Erozioni i tokës dhe i materialit gjenetik. Në këtë periudhë, vëmendja e mbrojtësve të natyrës u përqëndrua pikërisht në ruajtjen dhe menaxhimin e atyre sipërfaqeve dhe llojeve të natyrës së virgjër, ku bimët dhe kafshët mund të përshtaten dhe riprodhohen. Politika e ruajtjes së natyrës in situ ose stacionare nëpërmjet ngritjes së një sistemi zonash të mbrojtura, po zhvillohen dhe po përmirësohen më tej, si domosdoshmëri për ruajtje afatgjatë të resurseve natyrore dhe atyre biologjike të trashëguara për t'ua lënë trashëgim brezave që vijnë.

- *Përshkrimi i vegjetacionit në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre;*

Mbulesa e shtresës barishtore në kullota dhe vlefshmëria e sajë varet nga përbërja llojore dhe raporti konkret i gjëndjes së llojeve Leguminose që zenë rreth 25%, – Graminace të cilat përfaqësohen me 60% të llojeve përbërëse dhe llojeve të tjerame rreth 15. Proçesi i transferimit të kullotave pranë njërive qeverisëse vendore, ose kthimit të tyre në pronësi të pronarëve të ligjshëm, në mënyrë të përvitëshme, rrjedhimisht ndryshojnë element të veçantë, duke krijuar një formë të re strukturore të pronësisë së fondit kullor.

- *Përshkrimi i faunës në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre;*

Treguesit e gjuetisë për vitin 2014 sipas regjistrimit kadastal të të gjuetisë (inventarizimi, regjistrimi i disa specieve kryesore të faunës së egër) për tre rrethet e Qarkut Berat janë si më poshtë:

		Lepur i egër	Derr i egër	Tëllëzë fushe	Kunadhe
Berati	495	10	0	0	380
Kuçova	240	0	0	0	0
Skrapari	568	8	0	0	40

- *Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj;*

Zonat e Mbrojtura janë sipërfaqe me vlera të veçanta të peizazhit, formacione të rralla gjeomorfologjike e pasuri të biodiversitetit. Ato kanë vlera kulturore, historike, arkeologjike e të trashëgimisë kulturore, të cilave u jepet një status i caktuar me ligj për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre. Sipas dokumenteve të IUCN, përpjekjet e para për të sqaruar terminologjinë e ZM u bënë në 1933, në Konferencën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Faunës dhe Florës në Londër. Sipas dokumentit, u përcaktuan katër kategori ZM: Park

Kombëtar, Rezervat Strikt Natyror, Rezervat i Florës dhe Faunës si dhe Rezervat që ndalon gjuetinë dhe mbledhjen e bimëve.

Në Qarkun e Beratit është parku Kombëtar” Mali i Tomorrit” por që është shumë larg me aktivitetin “Grumbullim, tregtim me shumicë dhe pakicë të skrapit dhe transport i tij”. Nuk ka zona të tjera të mbrojtura, monumente natyrore pranë vëndit ku ushtron aktivitetin GRAMOS FISHKA.

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe riparime të automjeteve, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshirë këtu edhe të mbetjeve urbane.

7.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Në ajër kemi shkarkime të gazeve të tillë si dyoksidi i karbonit, dyoksidi i squfurit, okside të azotit, etj. gjatë kohës që kryhen proceset e prerjes së metalit nën flakën e oksigjenit si dhe gjatë kohës që janë në punë automjetet që futen/punojnë brenda teritorit të subjektit. Janë gaze të shkarkuar të kufizuar në kohë dhe sasi, të cilët “nuk mbesin” në mjedis duke përkeqsuar treguesit cilësor të tij. Ato mbarten lehtësisht nga rrymat e ajrit duke ulur ndjeshëm hollimin e tyre ndaj përqëndrimit në burim, sepse shkarkimi i tyre bëhet në ambjente të hapura. Të tilla shkarkime nuk ndikojnë në parametrat e cilësisë së ajrit në këtë mjedis rural.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjatë zhvillimit të proceseve të prerjes së metalit krijohen zhurma intensiteti i të cilave nuk kalon 70-80 DbA, në vendin ku ato gjenerohen.

Gjenerimi i këtyre zhurmave është i përkohshëm sepse ato janë të pranishme në vendet e punës sa kohë zhvillohen këto procese (vetëm disa orë paradite) dhe nuk janë të pranishme gjatë orëve të pasdites dhe të natës. Sigurisht që nuk gjenerohen zhurma edhe në fund javë dhe ditët e festave zyrtare.

Kështu ndikimet nga zhurmat, në popullsinë lokale pothuajse është minimum. Në lidhje me mbrojtjen nga zhurma të punonjësve të subjektit, duhet thënë se ato përdorin kufje mbrojtëse.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

- Pjesë metalike, plastike, gome, tekstili etj.

Pjesët metalike dhe ato plastike mblidhen në vende të caktuara dhe në fund të çdo muaji ato dërgohen në subjekte që merren me riciklimin e tyre. Subjekti ka lidhë kontrata me subjekte të licensuara për asgjësimin e këtyre mbetjeve.

- Mbetje inertesh.

Këto lloj mbetjesh, sistemohen në një vend të caktuar brenda hapsirës së subjektit dhe në fund të çdo muaji dërgohen në sheshin e depozitimit të mbetjeve inerte të përcaktuar nga Bashkia Berat.

- Mbetjet urbane të cilat përbëhen kryesisht nga ambalazhet e letrës/kartonit, plastikës, qelqit etj.

Shkojnë çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të vendosur pranë subjektit dhe, largohen prej andej nga subjekti i kontraktuar nga Bashkia Berat.

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlerësohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme" për t'u shpallur "Peizazh i mbrojtur".

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërme do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,

- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerike egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtrohet projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohëzgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapsinore të shtrirjes së një ndikimi të vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim. Duke vlerësuar llojet e elementëve ndotës të shkarkuar në mjediset e vendeve të punës, sasitë respektive të tyre si dhe drejtimin e erërave, gjykojmë se kemi të bëjmë me një shtrirje të kufizuar të përhapjes së tyre.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm apo ndikim të përkohshëm. Pothuajse të gjithë ndikimet negative në mjedis si psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj. janë ndikime të përkohëshme. Gjenerimi i elementëve ndotës në mjediset e vendeve të punës, ndërpritet sapo ndërpritet apo ndalon puna e pajisjeve që i gjenerojnë ato. Një tjetër element i përkohshmërisë është edhe zhvillimi i kësaj veprimtarije vetëm në një periudhë 8 orë në ditë, zakonisht paradite dhe ndërpreja e saj në ditët e pushimeve zyrtare përfshi këtu të shtunat e të djelat.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe rigjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimet më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimitë identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përkeqësim të treguesve cilësor aktualë të mjedisit.

IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjerie të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.

- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit European. Janë pajisje bashkëkohore, disa me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjie të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

XI. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë të konsiderueshme kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjrike (ndërtesë, rrjete inxhinjrike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarie.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigoroze të cilat kërkojnë gjithashtu procedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do të hidhen mbeturinat që do të krijohen, metalike, plaste, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarie nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluara. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

XII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Proçesit të prerjes me gurë zmerili
		Punës së mjeteve ngritëse dhe transportuese
Shkarkimet në ajër	Çdo 6 muaj	Gjatë prerjes së metaleve

- FUND -

Ermal



LOERMA SHPK
NIPT: L02928204T